



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2021:175093

Datë: 15.12.2023

Numri i dokumentit: 05069998

NË EMËR TË POPULLIT

P.nr.550/21

GJYKATA THEMELORE NË PËJË-Departamenti i Përgjithëshëm, Divizioni Penal, gjyqtari Leon Përlaska me zyrtarën ligjore Shpresa Kërnya, në çështjen penale kundër të pandehurit S. O. , i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë PP/II.nr.1269/21 të datës 06.08.2021, për shkak të veprës penale Kanosje nga neni 181 par.3 lidhur me par.2 të KPRK-së, në seancën publike të shqyrtimit fillestar të mbajtur me datë 11.12.2023, e mbajtur në prezencë të prokurorit të shtetit Dorjan Juniku dhe të pandehurit S. O. me mbrojtësin sipas detyrës zyrtare Av.Taulant Baloku, me të njëjtën datë shpalli ndërsa me datë 14.12.2023 përpiloi këtë:

AKTGJYKIM

I pandehuri:

S. O. , i lindur me dt. ...., në Istog, me banim në fsh. K. K. Istogut, i biri i H. dhe nënës H. e vajzërisë U., posedues i nr. tel. 044/....-...., i identifikuar në bazë të letërnjoftimit me nr. ...., i nacionalitetit Shqiptar, shtetas i Kosovës .

SHPALLËT FAJTOR

Për shkak se :

Me datën 01.07.2021 rreth orës 15:30min në Pejë rr. “H. P.”, me fjalë, seriozisht e kanos personin zyrtar në lidhje me pozitën e saj se do ta privoj nga jeta dhe atë të dëmtuarën/Drejtoreshën e mirëqenies sociale në KK Pejë S. M., në atë mënyrë që, e dëmtuara në pozitën e lartcekur kishte si detyrë edhe trajtimin dhe përcjelljen për Ministri kërkesat e personave që pretendojnë të jenë përfitues të pakos fiskale dhe i pandehuri pa i plotësuar kushte për këtë pako, i shkruan SMS të dëmtuarës me fjalët “*Sot e nesër ki afat që jam përfitues i pakos fiskale përndryshe shko e mbyte*”

*veten dikun, sepse unë s'jam i Istogut po i Pejës edhe ti nuk e ki lshu vendimin për mos unë pakon fiskale deri nesër të pres ose vjerru” për çka tek e dëmtuara shkakton frikë dhe panik,*

- me këtë ka kryer veprë penale “Kanosje” nga neni 181 par. 3 lidhur me par. 2 të KPRK-së.

Prandaj në kuptim të nenit 364 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës dhe nenit 38, 39, 40, 42,69 dhe 70 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës ( 06/L-074):

## GJYKON

Të pandehurit S. O. i shqipton:

- I. DËNIM ME BURGIM në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajsh, i cili dënim do të ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- II. Obligohet i dënuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 euro dhe në emër të fondit për kompensimin e viktimave të krimit të paguaj shumën prej 20 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit me detyrim.
- III. Kërkesë pasurore juridike nuk pati nga pala e dëmtuar.

## ARSYETIM

### A. Historiku i çështjes;

Prokuroria Themelore në Pëjë-Departamenti i Përgjithshëm pranë kësaj gjykate me datë 06.08.2021 ka paraqitur aktakuzën PP/II.nr.1269/2021 kundër të pandehurit S. O. për shkak të veprës penale Kanosje nga neni 181 par.3 lidhur me par.2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Gjykata e mbajti seancën e shqyrtimit fillestar me datë 11.12.2023, në të cilën seancë prezantuan prokurori i shtetit Dorjan Juniku, i pandehuri dhe mbrojtësit i tij i autorizuar av.Taulant Baloku, ku pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit i pandehuri e pranoi fajësinë për veprën penale që i vihet në barrë, pastaj gjykata e mori mendimin e prokurorit të shtetit dhe mbrojtësit

të pandehurit lidhur me pranimin fajësisë e si rrjedhojë në kuptim të nenit 242 par.2, 3 dhe 6 të KPPRK-së, e aprovoj pranimin e fajësisë të bërë nga i pandehuri.

Pas aprovimit të pranimin të fajësisë, gjykata e mori mendimin e palëve në lidhje me llojin dhe lartësinë e dënimit, ku prokurori i shtetit deklaroi “ Duke marr përsysh se këtu i pandehuri S. O. , e pranoj fajësinë konform kushteve ligjore të parapara me nenin 242 të KPPRK-së, përkatësisht dhe në përputhje të plotë me të gjitha provat materiale dhe personale në të cilat mbështet kjo aktakuzë, nga Gjykata kërkoj që të pandehurën ta shpall fajtore, ta dënoj sipas ligjit si dhe ti obligoj në paguarjen e shpenzimeve të procedurës penale, ndërsa me rastin e përcaktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit pranimin e fajësisë ta vlerësoj si rrethanë lehtësuese”.

Mbrojtësi i pandehurit Avokati Taulant Baloku, deklaroi “ I propozoj gjykatës që me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin si rrethanë lehtësuese të vlerësoj pranimin e fajësisë të bërë në të gjitha fazat e procedurës , pendimin e keqardhjen për veprën e kryer, kërkim faljen dhe premtimin se në të ardhmen nuk do ta përsërisë veprën, është hera e parë që akuzohet për vepër penale, andaj i propozoj gjykatës që të mbrojturit tim ti shqiptoj dënim sa më të butë ”.

I pandehuri deklaroi se “ Sa i përket këtij rasti mu më vjen keq prej juve, por sa i përket drejtoreshës unë mendoj se ajo duhet me u largu prej punës, unë nuk e kam pa të nevojshme me i kërku falje të njëjtës, bile ajo është dashtë me më kërku falje mu sepse unë mendoj se kam pas të drejtë si qytetar ”.

#### B) Vendimi në lidhje me dënimin;

Gjykata kur vendosi në lidhje me llojin dhe lartësinë e dënimit të përcaktuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi u bazua në nenet 38, 39, 42 dhe 70 të Kodit Penal të Kosovës dhe atë duke pasur parasysh qëllimin e dënimit, rregullat e përgjithshme për matjen e dënimit si dhe duke vlerësuar rrethanat lehtësuese dhe renduese të nxjerra nga faktet e çështjes .

- Përcaktimi i dënimit me burgim;

Për veprën penale për të cilën është shpallur fajtor i pandehuri ligjvënësi ka paraparë mundësinë e shqiptimit të dënimit me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet, ku pastaj gjykata

pasi i vlerësoj rrethanat e rastit, e beri individualizimin e dënimit si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Përcaktimi i dënimit me burgim prej gjashtë (6) muaj u bë dukë e filluar matjen e dënimit nga pikënisja e dënimit, qe sipas praktikës gjyqësore pikënisje është pika e mesme e minimumit dhe maksimumit të dënimit për veprën penale përkatëse. Në këtë rast pikë e mesme e dënimit për veprën penale Kanosje nga paragrafi 3 i KPRK-së është dënimi prej dy vite e gjashtë muaj burgim.

Pastaj, duke vlerësuar rrethanat renduese dhe lehtësuese të rastit, duke bërë peshimin e tyre si dhe duke aplikuar dispozitat ligjore përkatëse për matjen e dënimit, gjykata vendosi për dënimin me burgim të shqiptuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

- Konstatimi i rrethanave renduese dhe lehtësuese nga gjykata;

Pas analizimit të provave qe e mbështesin akuzën dhe deklarimeve të palëve, gjykata si rrethanë renduese për te pandehurin e gjeti shkallën e lartë të dashjes gjatë kryerjes së veprës penale, e cila është e shprehur përmes insistimit të të pandehurit qe te gjeje numrin e të dëmtuarës, ti drejtohet personalisht me fjalë kërcënuese, me qëllim qe të shkaktoj frikë të njëjtës, e përmes frikësimit të detyroj të dëmtuarën qe te ndërmarr veprime në favor të tij, qe në këtë rast ishte përfshirja e tij në skemën e pakove fiskale në kohën e pandemisë.

Dashja e të pandehurit e cila është derivat e motivit për realizimin e një interesi pasuror, e drejtuar si kanosje ndaj një personi zyrtar në këtë rast të dëmtuarës S. M., paraqet një veprim të rrezikshëm shoqëror, i cili nëse nuk e merr ndëshkimin e duhur, mund të ketë shkak përsëritjen e këtyre veprimeve, me të cilat cenohet jeta dhe siguria e personave zyrtar, gjë qe do të ndikonte në mënyrë të drejtpërdrejtë në pamundësimin e ushtrimit të detyrave zyrtare dhe me këtë rast edhe funksionimin e lirë të institucioneve shoqërore.

Kjo vepër penale edhe pse është e kategorizuar në kapitullin e veprave penale kundër jetës dhe trupit, në thelb të saj pa asnjë mëdyshje e cenon të mirat e mbrojtura përmes kapitullit të veprave penale kundër rendit kushtetues, pasi qe në mënyrë direkte e godet funksionimin institucional të shtetit dhe seriozisht e rrezikon rendin juridik, andaj edhe është e nevojshme qe kryerësi i saj përmes dënimit ta kuptoj rëndësinë e veprimeve te veta.

Si rrethana lehtësuese gjykata gjeti pranimin e fajësisë të bërë nga i pandehuri në seancën e shqyrtimit fillestar, mirëpo gjykata nuk i dha peshë të madhe kësaj rrethanë, duke marr parasysh se i pandehuri nuk shprehi keqardhje për veprimet e veta, për me tepër i njëjti i arsyetonte veprimet e tij kinse ka pasur të drejtë si qytetar dhe nuk shprehi fare pendese për veprën e kryer.

Gjykata pasi vlerësoj rrethanat lehtësuese dhe renduese erdhi ne përfundim se rrethanat renduese i mbi peshojnë rrethanat lehtësuese, prandaj me gjithë pranimin e fajësisë, gjykata vendosi qe të pandehurit ti shqiptoj dënim me burgim efektiv si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata është bindur se dënimi i shqiptuar të pandehurit është në përputhshmëri të plotë me qëllimin e dënimit të përcaktuar në nenin 38 të KPK-së dhe se ky dënim do të parandalojë kryesin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, do të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale te ngjashme dhe shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale të kryer nga i pandehuri.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale për paushallin gjyqësor u mor në kuptim nenit 450 par.1 dhe par.2 nën paragrafi 2.6 dhe nenin 453 par.1 të KPPK-së.

Vendimi lidhur me taksën për kompensimin e viktimave të krimit, u mor në bazë të nenit 36 par.3 pika 1 të Ligjit 08/L-109, për kompensimin e viktimave të krimit.

Kërkesë pasurore juridike nuk pati, pra pala e dëmtuar nuk paraqiti kërkesë për kompensimin e dëmit siç parashihet nenin 458 par.1 të KPRK-së, si rrjedhojë gjykata nuk vendosi për kompensim te demit e as nuk e udhëzoi në kontest civil palën e dëmtuar.

Andaj, duke u mbështetur në fakte, provat dhe dispozitat ligjorë nga neni 364 dhe 369 të KPPRK-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE PEJE**  
Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Penal  
P.nr.550/21, me datë 14.12.2023

Numri i lëndës: 2021:175093  
Datë: 15.12.2023  
Numri i dokumentit: 05069998

Procesmbajtësja:  
Shpresa Kërnya

Gjyqtari i vetëm gjykues:  
Leon Përlaska

**KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 30 ditësh nga pranimi i të njëjtit, ankesa paraqitet në këtë gjykatë për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.